



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2024:023932
Datë: 28.10.2024
Numri i dokumentit: 06361247

C.nr.846/24

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil, gjyqtarja Edona Zuzaki, me bashkëpunëtorin profesional Milot Mehmeti, në çështjen kontestimore të paditëses I.K nga Gjilani, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Av. M.N¹ nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit – Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimi i shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit, me vlerë të kontestit 908.90 euro, jashtë seance gjyqësore, më datë 17.10.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditëses I.K nga Gjilani, dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjilanit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, për periudhën kohore 22.01.2021-21.11.2022, për 190 ditë pune, duke llogaritur nga 2 euro në ditë, t'ia paguaj paditësit shumën prej 380.00 euro, dhe për të njëjten periudhë në emër të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit, duke llogaritur 70 %, të vlerës së biletës së trafikut urban, t'ia paguaj paditëses shumën prej 372.40 euro, apo shumën e përgjithshme prej 752.40 euro, me kamatë ligjore prej 8 % nga data 09.01.2024, si datë e paraqitjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

II. REFUZOHET e pabazuar kërkesa për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe në emër të kompensimit për ushqim, e kërkuar më tepër se shuma e gjykuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në shumën prej 156.50 euro.

III. DETYROHET e paditura që t'ia paguaj shpenzimet e procedurës paditëses në shumën e përgjithshme prej 124.00 euro, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

A r s y e t i m

¹ Në padinë fillestare është përfaqësuar me autorizim nga avokati N.D, kurse me autorizimin e vaeçant të dhënë nga paditësja në muajin shtator 2024, ka autorizuar avokatin M.N, nga Gjilani, për të përfaqësuar në procedurë administrative, jokontestimore, kontestimore dhe përmbarimore në të gjitha instancat përkatëse lidhur me çështjet e realizimit të të hyrave, kompensimeve nga mardhënia e punes.

Paditësja, përmes të autorizuares së saj, më datë 09.01.2024, ka paraqitur padi, kurse me datë 04.10.2024, parashtrësë për ndryshimin e kërkesëpadisë duke bërë zmadhimin e kërkesëpadisë në këtë gjykatë kundër të paditurës për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit, në vlerë prej 908.90 euro.

Në padin ka theksuar se e njëjta është e punësuar në Shkollen Fillore të Mesme e Ulët (në vijim: SHFMU) “Skenderbeu” në fshatin Përlepnice Komuna e Gjilanit, dhe në Shkollen Fillore të mesme e Ulët (në vijim: SHFMU) “Vatra e Diturisë” në fshatin Livoq i Epër Komuna e Gjilanit, në cilësinë e e mësimdhënëses. Bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë (në vijim: KKAK) të datës 22.01.2021 ka shtuar se paditësit i takon kompensimi për shpenzimet e ushqimit dhe udhëtimit për periudhën kohore 22.01.2021– 21.11.2022. Gjykatës i ka propozuar të aprovojë të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe të detyrojë të paditurën t’ia kompensojë kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit në shumën prej 908.90 euro. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumën prej 104.00 euro për përpilim të padisë dhe 20.00 euro për taksë gjyqësore.

E paditura me shkresën e datës 04.12.2023 ka parashtruar përgjigje në padi lidhur me të gjitha çështjet kontestuese sa i përket kërkesave: shpërblim jubilar, ushqim, udhëtim, kualifikim dhe inflacion, të cilat rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit e vitit 2017 dhe 2021 si dhe Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr.01/33 të datës 29.08.2008. Meqë objekt kontesti i kësaj çështje juridike është kompensimi për shpenzime të ushqimit, gjykata vlerëson se kjo shkresë shërben si përgjigje në padi në lëndën konkrete. Kundërshtimet e të paditurës theksojnë se sa i përket kompensimit të shpenzimeve për udhëtim, të njëjtat nuk duhet të njihen nëse nuk argumentohen me prova përkatëse (certifikatë e vendbanimit, pagesë mujore në kompani transportuese, çmimi i biletës...). Sa i përket diferencës në pagë për shkak të kualifikimit, vendimi i qeverisë në fjalë është zbatuar sipas detyrës zyrtare posa ka hyrë në fuqi (me rastin e rritjes së pagave), andaj vendimi i njëjtë nuk mund të zbatohet dy herë. Sa i përket inflacionit, kjo e drejtë nuk i takon të punësuarve në sektorin e arsimit, pasi nuk mund të godet vetëm një sektor të punësimit, por të gjithë sektorët e aparatit shtetëror. Për të gjitha kërkesat, gjykatës i ka propozuar të vlerësojë parashkrimin e tyre, bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës dhe kërkesave periodike nga Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seance gjyqësore, bazuar në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), në të cilën është përcaktuar se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit merititor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”.

Gjykata ka gjetur se mes palëve nuk është kontestuese se paditësja është e punësuar te e paditura dhe për periudhën kohore 22.01.2021 – 21.11.2022, ka gjithsej 305 ditë të pranisë në punë, (fakt i vërtetuar edhe nga vërtetimi nr.prot.235/2024 i dt.26.09.2024, i lëshuar nga SHFMU “Vatra e Diturisë” në Livoq të Epërm, dhe vërtetimi me nr.prot.511/1 i dt.26.09.2024, i lëshuar nga SHFMU “Skenderbeu” në Përlepnice), nuk është kontestuese se e njëjta ka

vendbanimin në Gjilan (fakt i vërtetuar edhe nga vërtetimi nr.prot.235/2024 i dt.26.09.2024, i lëshuar nga SHFMU “Vatra e Diturisë” në Livoq të Epërm); e as nuk është kontestuese se bileta njëdrejtimëshe Gjilan-Përlepnice dhe Gjilan – Livoq i Eperm, është 0.70 euro (fakt i vërtetuar nga aneks çmimorja e biletave të lëshuara nga SHTU “Anamorava”).

Gjykata bazuar në nenin 329.1 të LPK-së, provat në shkresat e lëndës i gjeti vendimtare për vendosje në këtë çështje meritore, pasi të njëjtat janë lëshuar nga organi shtetëror – këtu vet e paditura, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Gjykata vlerësoi se nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritor, pasi themelësia e kërkesëpadisë, e aprovuar si në pikën I dhe jo themelësia e kërkesëpadisë si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi del bazuar në dispozitat e nenit 55, paragrafi 1 të Ligjit të Punës që përcakton se “I punësuar ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”; nenit 90, paragrafi 5 se “Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”; lidhur me dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, nga neni 3, paragrafi 2 që përcakton se “I (e) punësuar do të thotë punëtor ose punëtore, i/e cili/cila ka lidhur marrëdhënie pune në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, Kontratës Kolektive në nivel të vendit dhe kësaj kontrate”; neni 35, paragrafi 5 se “Punëtorët arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse, i paguhen 70 %, të biletës së trafikut urban; dhe paragrafi 7, se: “Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune është 2€ (dy euro) për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit të kuzhinës ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”.

Dispozitat e Kontratave Kolektive të Arsimit për vitin 2021 aplikohen për periudhën 22.01.2021 – 21.11.2022, zbatimi i të cilave është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr.214/2023 të datës 05.10.2023.

Lartësinë e kërkesëpadisë, gjykata e vërtetoi nga fakti se për shpenzimet e ushqimit nga 2 euro në ditë, për 190 ditë në total, arrijnë vlerën prej 380.00 euro dhe për shpenzimet e udhëtimit për 70 % të çmimit për dy drejtim të biletës (1.40 euro) arrijnë vlerën prej 372.40 euro.

Nga të theksuarat më sipër, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke i aprovuar të bazuar kërkesëpadinë paditëses për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit.

Për kamatën, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së.

Në nenin 87 të LP-së, është përcaktuar se “Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”, prandaj gjykata

duke marrë parasysh faktin se kërkesa e paditësit është kërkesë monetare nga marrëdhënia e punës dhe e paditura është thirrë në parashkrim të kërkesës, gjeti se për 3 vite mbrapa nga data e inicimit të padisë në këtë gjykatë (09.01.2024), respektivisht parashtreses për ndryshimin e kërkesëpadisë duke bërë zmadhimin e kërkesëpadisë (04.10.2024), jesa tjetër e kërkesës së paditëses deri më datë 04.10.2021 është e parashkruar edhe atë sa i përket kërkeses për zmadhimin e kërkesëpadisë, pasi që paditësja me parashtresen për zmadhimin e kërkesëpadisë ka kërkuar kompensimin edhe për 130 ditë shtesë të kompensimit për shpenzimet e udhëtimit dhe ushqimit, ku nga kjo kërkesë sipas parashtreses së paraqitur janë aprovuar vetem ditet e punës për periudhen kohore 03.10.2022 – 21.11.2022, bazuar në vërtetimin me nr.prot.235/2024 të dt.26.09.2024, lëshuar nga SHFMU “Vatra e Diturisë” Livoq i Eperm - Gjilan.

Prandaj, bazuar në nenin 87 të LP-së, kërkesa e paditëses deri më datë 04.10.2021, pjesërisht është e parashkruar dhe atë sa i përket kërkeses për zmadhimin e kërkesëpadisë, ashtu qw gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata ka refuzuar edhe një pjesë të kërkesës që nuk është e përfshirë në parashkrim, nga data 04.10.2021 deri më datë 02.10.2022, mirëpo në mungesë të provave për të vërtetuar se sa ditë ka vijuar në shkollë paditësja për këtë periudhë, gjykata vlerësoi se nuk mund t’a kompensojë shpenzimin e ushqimit dhe udhëtimit paditëses, i cili kompensim realizohet vetëm për aq ditë sa i punësuari ka qenë në punë.

Për më tepër, gjykata vlerëson se është detyrim i paditësve të mbështesin me prova faktet e tyre bazuar në nenin 7 të LPK-së, prandaj në mungesë të provave për këtë periudhë, gjykata i refuzoi të pabazuar të njëjtat dhe i njohi vetëm periudhën për të cilën vërtetohet sa ditë të pranisë ka qenë paditësja në punë, e këto ditë, nuk përfshihen në parashkrim të kërkesës.

Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në nenet 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e paditëses në këtë procedurë dhe kërkesën e specifikuar për këto shpenzime, ndërsa sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës u bazua në nr. tarifor 6 dhe 7 të Rregullorës për Tarifën e Avokatëve të Kosovës.

Nga të lartëcekurat, bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 398 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.846/24, datë 17.10.2024

Gjyqtarja,
Edona Zuzaki

Numri i lëndës: 2024:023932
Datë: 28.10.2024
Numri i dokumentit: 06361247

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimi të të njëjtit. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj gjykate.